

## **BORXHI I JASHTËM I KOSOVËS – PARIMET KRYESORE**

Më 26 shkurt 2008, Ministri i Financave të Serbisë, z. Dinkiq ka deklaruar se Serbia duhet t'i ndalojë pagesat e borxheve të Kosovës, pasi që kjo e fundit e ka shpallur pavarësinë më 17 shkurt 2008. Qeveria e Serbisë do të vazhdojë ta diskutojë qëndrimin e saj rreth kësaj çështjeje. Sipas qeverisë së Serbisë, borxhi i supouar është llogaritur të jetë rreth 1,264 miliardë dollarë amerikan. Çështja e borxhit dhe si duhet të zgjidhet ky problem është diskutuar në negociatat e fundit në mes të Prishtinës dhe Beogradit në procesin e udhëhequr nga Ahtisari në Vjenë. Rreth gjysma e borxhit është ndaj Bankës Botërore, ndërsa gjysma tjetër është borxh ndaj Klubit të Parisit dhe atij të Londrës.

Ligjërisht, Kosova nuk është nënshkruese e këtyre kredive dhe si e tillë asnjë pjesë e borxhit nuk mund t'i transferohet automatikisht. Nënshkruese e borxhit ka qenë Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, dhe pasardhëset e saja, Republika Federative e Jugosllavisë, Serbia dhe Mali i Zi, si dhe në fund Serbia. Në aspektin ligjor, Qeveria e Serbisë është përgjegjëse për borxhin dhe çfarëdo ndalese e pagesës së borxhit pa marrëveshje me kreditorët dhe Republikën e Kosovës do të ketë pasoja vetëm për Serbinë. Megjithatë, autoritetet e Kosovës duhet të theksojnë përsëri gatishmërinë për të diskutuar këtë çështje.

Rekomandohet që sa i përket çështjes së borxheve, Qeveria e Kosovës t'i koordinojë politikat në bazë të parimeve në vijim:

- 1) **Kosova duhet të shprehë gatishmërinë që të merr përsipër kthimin e kredive,** që janë përdorur për projekte në Kosovë. Ekziston një numër i projekteve në Kosovë të cilat janë financuar nga këto kredi. Kosova nuk duhet ta mohojë këtë dhe në rrugën drejt zhvillimit të shtetit të qëndrueshëm dhe të respektueshëm, duhet të pranojë obligimin moral që të merr përsipër borxhet të cilat i takojnë asaj.
- 2) **Kosova duhet t'i pranojë borxhet vetëm pasi të verifikojë se ato fonde janë investuar në Kosovë.** Kjo mund të bëhet duke e verifikuar dokumentacionin origjinal të kredive që momentalisht gjendet në Beograd. Pasi që borxhi është ndaj shumë kreditorëve individual është joreale të pritët që ky informacion mund të mblidhet nga këto institucione. Kosova nuk duhet të marrë përgjegjësinë për çfarëdo pjese të borxhit në qoftë se nuk ka qasje në këtë dokumentacion.
- 3) **Kosova duhet të jetë e gatshme të diskutojë me Beogradin çështjen e borxheve siç është paraparë në Planin e Ahtisarit.** Ekzistojnë disa raste ku dy shtete të ndara kanë diskutuar çështje të suksesionit. Gjithashtu, të gjitha shtetet e tjera të pavarura të ish-Jugosllavisë kanë negociuar ndarjet e pasurisë dhe borxheve. Rasti i fundit

ishte pavarësimi i Malit të Zi. Në shumicën e rasteve, pasi që diskutimet përfshijnë edhe ndarjen e kredive të paalokuara, (kreditë e përgjithshme), marrëveshjet përfshijnë edhe ndarjen e pasurive të shtetit, si edhe çështje të tjera të pazgjedhura të ndarjes.

Këto parime sigurojnë që Kosova është gati që të diskutojë pasuritë dhe obligimet për t'i respektuar përgjegjësitë dhe obligimet e veta; dhe vepron në pajtueshmëri me parimet e Planit të Ahtisarit duke mos i dëmtuar interesat e saja financiare.